

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 771 Prot.


Tiranë, më 19.07 2016

VENDIM Nr. 76, datë 15.07.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 9 të datës 15.07.2016, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *Projektit "Linja e Gazsjellësit TRANS ADRIATIK (TAP), Fushata e Parë KM 211.8 - KM 145"-shoqëria TAP AG*, realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Lorenc Bejko,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *Projektit "Linja e Gazsjellësit TRANS ADRIATIK (TAP), Fushata e Parë KM 211.8 - KM 145"-shoqëria TAP AG*, realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Lorenc Bejko.
2. Për zonat me potencial të lartë arkeologjik, kodra rreth fshatit Petovë, kodrat midis fshatrave Kutalli dhe Sqepur, kodrat nga fshati Ullinjas në fshatin Duhanas dhe pikërisht në pikat e mëposhtëme të këtyre zonave:
 - Pika kilometrike 193+750 (midis APL 73 dhe APL 74)
 - Pika kilometrike 192+250 (midis APL 79 dhe APL 80)
 - Pika kilometrike 171+300 (APL 163)
 - Pika kilometrike 170+500 (midis APL 166 dhe APL 167)
 - Pika kilometrike 150+400 (APL 247)
 - Pika kilometrike 150 (midis APL 248 dhe APL 249)të hartohet koncepti i sondazheve arkeologjike, i cili të paraqitet në KKA e radhës.
3. Shoqëria "TAP AG" duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të zbatimit për projektin *"Linja e Gazsjellësit TRANS ADRIATIK (TAP), Fushata e Parë KM 211.8 - KM 145"-shoqëria TAP AG*, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E KULTURËS

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO